

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 251, datë 09.05.2024

**PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR ULJEN E NUMRIT TË ÇËSHTJEVE TË
PRAPAMBETURA NË GJYKATA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenet 89 dhe 94 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë,” të ndryshuar , me propozim të tre anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}, z. {...} dhe znj. {...},

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Strategjia kombëtare e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë (2024-2027)

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR



WWW.KLGJ.AL

Mađ2024

Tabela e lëndës

Parathënie	3
Kuadri institucional dhe ligjor	5
Metodologjia dhe procesi i hartimit	6
Përshkrimi i situatës aktuale	7
Analiza e prirjeve aktuale në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit	7
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	7
Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	9
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	10
Gjykata Administrative e Apelit.....	11
Burimet njerëzore	12
Gjyqtarët	12
Stafi mbështetës	13
Strategjia për uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	14
Misioni dhe vizioni për uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	14
Misioni i strategjisë	14
Vizioni i strategjisë	14
Synimet strategjike për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura	14
Objektivi 1: Ulja strukturore e numrit të çështjeve të prapambetura nëpërmjet marrjes së masave ...	15
konkrete për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura	15
Objektivi 2: Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit (gjyqtarëve dhe ndihmësve ligjorë)	16
Objektivi 3: Përmirësimi i metodave të punës	18
Objektivi 4: Ndryshimet ligjore të përqendruara në uljen dhe parandalimin e çështjeve të	19
prapambetura	19
Objektivi 5: Përcaktimi i standardeve minimale të kohës dhe sasisë dhe matja e performancës.....	20
Objektivi 6: Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me aktorë të tjerë	20
Objektivi 7: Rritja e Transparencës dhe e Besimit të Publikut	21
Llogaridhënia, Monitorimi dhe Vlerësimi	21
Skenarët për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura	21
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	21
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	22
Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	23
Gjykata Administrative e Apelit.....	23
Përfundime të përgjithshme të skenarëve (përfshirë objektivat për uljen e numrit të çështjeve të	24
prapambetura)	24
Konkluzionet dhe rekomandimet për zbatimin e strategjisë	24
Shtojcat.....	25
Shtojca 1: Plani i Veprimet - Reduktimi i çështjeve të prapambetura në Gjykatë	25
Shtojca 2: Plani strategjik me masat, planifikimet e propozuara, veprimet që duhen ndërmarrë	25
dhe lista e treguesve për matjen e arritjes së qëllimeve, strategjitë për reduktimin e çështjeve të	25
prapambetura të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit në Shqipëri.....	32

Parathënie

Dhënia e drejtësisë pa vonesa dhe përmirësimi i efikasitetit të gjykatave mbeten ndër objektivat kryesore të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Zbatimi i hartës së re gjyqësore përgjatë vitit 2023 synoi jo vetëm ekuilibrimin e ngarkesës nëpër gjykata, por mbi të gjitha për të unifikuar cilësinë e shërbimeve

dhe drejtësisë së dhënë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2023, **113.768 çështje u konsideruan në pritje për shqyrtim** në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Këto nivele të çështjeve të prapambetura rrezikojnë të kthehen në pengesën më serioze për aksesin në drejtësi. Prandaj, Këshilli i Lartë Gjyqësor është i angazhuar maksimalisht për uljen e çështjeve të prapambetura në gjykata dhe, po aq i angazhuar, edhe për parandalimin e tyre në të ardhmen, me objektivin përfundimtar të funksionimit efikas dhe cilësor të sistemit të drejtësisë. Prioriteti i Këshillit në këtë fushë korrespondon më së miri edhe me detyrimet e vendosura ndaj Shqipërisë nga Bashkimi

European për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE.

Kuadri institucional dhe ligjor

Strategjia për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura është në përputhje me objektivat strategjike të Planit Strategjik të KLGJ-së 2022 - 2024; Strategjinë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021 - 2025 të Ministrisë së Drejtësisë dhe e harmonizuar me prioritetet e politikave kombëtare, siç përshkruhen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 “Për krijimin e një sistemi drejtësie të pavarur, llogaridhënës dhe efikas në Shqipëri, i cili është në gjendje të japë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi drejtues përgjegjës për emërimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve, si dhe për administrimin e drejtësisë nga gjykatat, përfshirë menaxhimin e buxheteve të gjykatave.

Gjykatat kanë detyrimin ligjor për administrimin e drejtësisë, bazuar në parimet e pavarësisë, drejtësisë, efikasitetit dhe cilësisë së lartë të ofrimit të shërbimeve të drejtësisë në përputhje me parimet dhe standardet europiane për funksionimin e duhur të gjyqësorit, siç përshkruhet në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe në parimet e shumta udhëzuese të ofruara nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Europës.

Metodologjia dhe procesi i hartimit

Bazuar në Urdhrin nr. 42, datë 20.07.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e çështjeve të prapambetura në gjykata”, i ndryshuar, i Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, u ngrit grupi i punës për uljen e çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Detyrat e grupit të punës, siç përshkruhen në urdhër, ishin:

- i. Vlerësimi dhe analizimi i situatës në lidhje me numrin e çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.
- ii. Identifikimi i shkaqeve bazë të grumbullimit të çështjeve të prapambetura dhe propozimi i masave konkrete për uljen e numrit të tyre.
- iii. Hartimi i planit të veprimit me masat konkrete që grupi i punës do t'i gjykojë të nevojshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në:
 1. Vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave dhe hartimin e propozimeve për standardet kohore (standardet minimale kohore) për gjykimin e kategorive të ndryshme të çështjeve.
 2. Vlerësimin e nevojave për përdorimin e kriterëve sasiore dhe hartimin e propozimeve lidhur me normën e shqyrtimit të çështjeve për gjyqtar, sipas kategorive të çështjeve me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave.
 3. Vlerësimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe hartimin e propozimit.
 4. Vlerësimin e numrit të nevojshëm të këshilltarëve ligjorë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit, dhe hartimin e propozimit përkatës.

Për realizimin e detyrave në mënyrë efektive janë emëruar këta anëtarë të grupit të punës: Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Kryetar i Grupit të Punës; Anëtarët e KLGJ-së Ridvan Hado dhe Irena Plaku; Ardian Dvorani, Zëvendëskryetar i Gjykatës Administrative të Apelit, Valdete Hoxha, Zëvendëskryetare e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Flamur Kapllani, Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe Bezart Kaçkini, Zëvendëskryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (i cili ka zëvendësuar ish-zëvendëskryetarin Gentian Hamiti.)

Nën drejtimin e kryetarit të grupit të punës dhe me ndihmën e projektit të financuar nga INL - Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit, “Për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura”, që zbatohet nga Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim (EWMI), Grupi i Punës hartoi strategjinë e uljes së çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, e cila u konsultua dhe u miratua nga Mbledhja Plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Grupi i punës u mbështet nga ekspertët kombëtarë të EWMI-t, Olta Lolo dhe Valbona Bala (Pajo), dhe ekspertët ndërkombëtarë Pim Albers dhe Jesper Wittrup. Gjithashtu, Grupi i Punës u mbështet me ekspertizë kombëtare dhe ndërkombëtare nga projekti i Këshillit të Evropës SEJ III, si dhe projekti EU4Justice. Që nga korriku 2023 deri në mars 2024, Grupi i Punës për Strategjinë e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura (në vijim “GP”) u mblodh dhe shqyrtoi shkaqet kryesore të krijimit të çështjeve të prapambetura, volumin e çështjeve (të vjetra) në pritje si dhe diskutoi zgjidhjet për pakësimin e strukturuar të çështjeve të prapambetura pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe Gjykatës Administrative të Apelit. Grupi i Punës u mblodh 13 herë deri në miratimin e kësaj strategjie. Kjo strategji është rezultat i punës së kryer nga ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë të Grupit të Punës.

Strategjia, plani i veprimit dhe masat konkrete u konsultuan vazhdimisht edhe në takime periodike me trupën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë si dhe me dy gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm dhe ai administrativ.

Strategjia përcakton përmasat e problemeve në gjykata, të cilat shkaktojnë volumin e madh të

çështjeve të prapambetura, ofron një perspektivë për sa i përket skenarëve për pakësimin e tyre në tri vitet e ardhshme, si dhe prezanton masa praktike për uljen e çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e tyre në të ardhmen, duke ofruar, gjithashtu, një sërë masash ligjore të nevojshme për uljen e çështjeve të prapambetura dhe përmirësimin e efikasitetit të drejtësisë në gjykatat shqiptare.

Strategjia është strukturuar si më poshtë:

- **Pjesa e parë** përshkruan situatën aktuale të gjykatave duke analizuar prirjet në çështjet e reja të ardhura në gjykatë, ato të gjykuara si dhe volumin aktual të çështjeve të prapambetura. Aty detajohet situata aktuale e burimeve njerëzore në gjykata (gjyqtarë dhe personel mbështetës) dhe ofrohet perspektiva për plotësimin e vendeve vakante në vitet e ardhshme.
- **Pjesa e dytë** paraqet synimet dhe objektivat e kësaj strategjie si dhe përshkruan masat kryesore për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e tyre.
- **Pjesa e tretë** diskuton skenarët e mundshëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura sipas zbatimit të objektivave të strategjisë.
- **Pjesa e katërt** ofron rekomandime për zbatimin e një strategjie kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata.
- **Shtojcat:** Plan Veprimi i detajuar për zbatimin e strategjisë në gjykata.

Përshkrimi i situatës aktuale

Analiza e prirjeve aktuale në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit

Statistikat e performancës së gjykatave fokusohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, si gjykatat me numrin më të lartë të çështjeve të prapambetura. Statistikat e paraqitura kanë shërbyer si bazë për përshkrimin e prirjeve në lidhje me çështjet e ardhura (civile, penale dhe administrative), çështjet e gjykuara (të përfunduara) dhe çështjet e prapambetura (çështjet e prapambetura në pritje). Gjithashtu gjykatat vlerësohen edhe për sa i përket Normës së Likuidimit të Çështjeve (NLÇ) apo raportit midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre të regjistruara rishtazi, që sipas rekomandimeve/standardeve minimale ndërkombëtare duhet të jetë në raportin 1:1 ose 100%. Duke parë këto shifra mund të krijohet një përshtypje e parë për efikasitetin e gjykatave, cilat janë zhvillimet në lidhje me ngarkesën dhe produktivitetin e tyre dhe sa të mëdha janë problematikat në fushën e çështjeve të vjetra në pritje (të pagjykuara)/çështjeve të prapambetura.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Lidhur me ngarkesën dhe performancën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (çështjet civile) për periudhën 2014 – 2023, ka një tendencë të përgjithshme të pakësimin gradual të çështjeve të ardhura. E njëjta prirje identifikohet edhe për numrin e çështjeve të gjykuara. Në vitin 2022/2023 janë gjykuar më pak çështje krahasuar me vitet e mëparshme. Për periudhën 2013 - 2018, ka pasur më shumë çështje civile të gjykuara krahasuar me numrin e çështjeve të ardhura (që do të thotë një normë të likuidimit të çështjeve më të lartë se standardi ndërkombëtar i pranuar prej 100%). Pas kësaj periudhe (me përjashtim të vitit 2022) norma e likuidimit të çështjeve ra nën 100, çka tregon një rritje të volumit të çështjeve (të vjetra) në pritje. Kjo është e dukshme edhe në prirjet e numrit të çështjeve të prapambetura. Kjo prirje ka ardhur në rritje të vazhdueshme për vitet 2013 – 2023.




Figura 1 Çështjet civile të ardhura, të përfunduara dhe të prapambetura në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Nga analiza e llojeve të çështjeve civile që kontribuojnë më shumë në numrin e çështjeve të prapambetura, konstatohet se janë 10 lloje çështjesh, të cilat hasen më shpesh kur bëhet fjalë për ndikimin e tyre në numrin total të çështjeve të prapambetura (81% e ngarkesës totale të gjykatës). Pjesën më të madhe të numrit të madh të çështjeve të prapambetura e zënë urdhrat e ekzekutimit (35% e çështjeve të prapambetura; 43% e tyre përfundojnë pas 6 muajsh), pasuar nga zgjidhjet e martesës, përmbushja e detyrimeve, paditë e pronësisë dhe shpërblimi i dëmit.

Sa i përket prirjeve në çështjet penale, konstatohet se ka një rritje graduale të numrit të çështjeve të ardhura ndër vite¹. Megjithatë, nga performanca e gjykatës, vërehet se, gjykata ka pasur një normë likuidimi të njëjtë me standardin ndërkombëtar prej 100%, pasi thuhet në çdo vit, numri i çështjeve të gjykuara është i njëjtë me numrin e çështjeve të ardhura. Kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se në ndryshim nga çështjet civile, çështjet penale kanë afate strikte për zgjidhjen brenda një kohe të arsyeshme. Pavarësisht nga sa më sipër vërehet se, gjykata ka një numër në rritje të çështjeve penale në pritje. Çështjet të cilat kanë një kohëzgjatje (më) të gjatë gjykimi (më shumë se 6 muaj) janë drejtimi në mënyrë të parregullt i automjeteve (20% e çështjeve, të cilat kontribuojnë në numrin total të çështjeve në pritje), të ndjekura nga çështjet e dhunës në familje (5,2% e çështjeve penale që kontribuojnë në numrin e përgjithshëm të çështjeve në pritje), prodhimi dhe shitja e narkotikëve (4,5%), vjedhja (4,3%) dhe mashtrimi (3%).

¹ Rritja e menjëhershme e numrit të çështjeve penale nga viti 2017 në 2018 shpjegohet si pasojë e një ndryshimi të natyrës teknike në mënyrën e regjistrimit të çështjeve penale, pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale.




Figura 2 Çështjet penale të ardhura, të zgjidhura dhe në pritje në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Në total numri i çështjeve në pritje të gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në fund të vitit 2023 është 19.275 çështje.

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm

Sa i përket Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka një tendencë të përgjithshme të rritjes së lehtë të çështjeve të ardhura. Në krahasim me një vit më parë shënohet një rritje me 2.3%. Por për sa i përket çështjeve të gjykuara vërehet një rënie e numrit të çështjeve të gjykuara. Para vitit 2019 zgjidheshin mesatarisht 17.000 çështje në vit, aktualisht ky numër ka rënë nën 10.000 çështje në vit. Kur shikohen dallimet në numrin e çështjeve të gjykuara në fushën civile dhe në fushën e së drejtës penale, duhet vënë në dukje se, veçanërisht, numri i çështjeve civile të përfunduara ka shënuar rënie me kalimin e kohës.

Është e evidente se, ashtu si edhe në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, çështjet civile po kontribuojnë më së shumti në volumin e çështjeve të prapambetura. Sidomos kjo është shkaktuar nga fakti se, ndër vite ka pasur një rritje të kohëzgjatjes mesatare të një çështjeje civile. Ndërsa para vitit 2013 duheshin 270 ditë për të zgjidhur një çështje civile, në 2023 kohëzgjatja ka arritur 1250 ditë, apo ndryshe një rritje pothuajse katërfish e kohëzgjatjes së regjistruar në vitin 2013.

Sa i përket mesatares së normës së likuidimit të çështjeve, për çështjet civile në vitin 2020, ajo shfaqet jo e kënaqshme me një vlerë prej 64% por me një tendencë në rritje. Kështu në vitin 2021 ajo shënon vlerën 73% dhe në vitin 2022 vlerën 85%. Në vitin 2023 për shkak të zvogëlimit të numrit të gjyqtarëve efektivë kemi edhe një ulje drastike të normës në 42%. Ky indikator është shumë larg pragut prej 100% duke treguar se, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm nuk arrihet të mbahet ritmi i çështjeve të evaduar duke vijuar shtimin e numrit të çështjeve të prapambetura.

E njëjta situatë paraqitet për këtë tregues për kategorinë e çështjeve penale duke shënuar një rritje graduale nga 3% ose 2% çdo vit, deri në vitin 2022, dhe një ulje me 14% në vitin 2023 pa arritur pragun e 100%, duke ndikuar negativisht në gjendjen e volumit të çështjeve të prapambetura.




Figura 3 Numri i çështjeve civile dhe penale të përfunduara në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Në total, numri i çështjeve në pritje të gjyqimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fund të vitit 2023 është 37.662 çështje.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Në mënyrë të ngjashme me analizën e kryer më lart, është shqyrtuar edhe performanca gjyqësore e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke parë kryesisht prirjet në çështjet e gjykuara dhe kohëzgjatjen mesatare të gjyqimeve. Pozitiv është fakti se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë gjykon në vit nga 10.000 deri në 14.000 çështje. Kur analizohen më hollësisht llojet e çështjeve të gjykuara, bie në sy prirja se me kalimin e kohës kemi një rënie të gjyqimit të çështjeve të themelit, ndërsa rritet numri i urdhrave të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata.




Figura 4 Numri i çështjeve të gjykuara sipas llojit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Lidhur me kohëzgjatjen mesatare të gjyqimeve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vërehet prirja për rritjen e kohëzgjatjes me kalimin e kohës për çështjet e themelit, kërkesat dhe urdhrat e ekzekutimit. Ndërsa në vitin 2015 kohëzgjatja mesatare për çështjet e themelit ishte nën 100 ditë, në vitin 2023 kjo është rritur në nivelin e më shumë se 300 ditëve. Gjithashtu, një prirje e ngjashme vërehet edhe për kërkesat pa palë kundërshtare, ku në vitin 2015 kërkesat janë zgjidhur për një muaj, ndërsa në vitin 2023, kohëzgjatja u rrit në më shumë se 3 muaj. Gjithashtu, sa i përket lëshimit të urdhrave të ekzekutimit, kohëzgjatja mesatare është rritur nga dy javë në 2015, në më shumë se një muaj në 2023. Duke parë trendin e përgjithshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të rritjes së kohëzgjatjes së gjyqimeve dhe rënies së numrit të çështjeve të themelit të

gjykuara, pritet që volumi i çështjeve (të vjetra) të prapambetura të rritet me kalimin e kohës. Norma e likuidimit të çështjeve për këtë gjykatë për vitin 2023 është 91% pra nën standardin ndërkombëtar prej 100%. Në total, numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të vitit 2023 arrin në 7095 çështje.

Gjykata Administrative e Apelit

Gjatë shqyrtimit të ecurisë së gjykimit të çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, prirjet që mund të identifikohen janë të ndryshme. Për shembull, midis 2014 dhe 2022 numri i çështjeve të ardhura është në rënie. Por kjo vlen edhe për numrin e çështjeve të gjykuara. Me përjashtim të viteve 2017 – 2018, Gjykata Administrative e Apelit nuk ishte në gjendje të mbante ritmin me volumin e çështjeve të ardhura, duke rezultuar në një normë të ulët të likuidimit të çështjeve. Në vitin 2019 kjo normë ishte 86 % ndërsa në vitet në vijim norma është ulur ndjeshëm (37% në vitin 2020, 21% në vitin 2021 dhe 24 % në vitin 2022). Në vitin 2023 vihet re një përmirësim në krahasim me vitet 2020-2022, pasi normal arrin në 43% por përsëri shumë larg standardit ndërkombëtar apo viteve të fillimit të veprimtarisë së kësaj gjykate. Gjithashtu vërehet se, numri i çështjeve të prapambetura është rritur në mënyrë radikale me kalimin e viteve. Ndërsa në 2014 numri i çështjeve të prapambetura ishte afërsisht 6000 çështje, në vitin 2023 shkoi në 23.056 çështje, duke shënuar një volum të lartë të çështjeve (të vjetra) të prapambetura. Bazuar në treguesit e mësipërm, për zgjidhjen e një çështjeje, tendenca është që, në kushtet aktuale, duhen mesatarisht 5326 ditë (14.6 vjet).




Figura 5 Përpunimi i çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit.

Nëse katër gjykatat krahasohen me njëra-tjetrën, është e qartë se sfidat në uljen e çështjeve të prapambetura janë shumë më serioze për dy gjykatat e apelit sesa për dy gjykatat e shkallës së parë. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, produktiviteti për sa i përket numrit të çështjeve civile të gjykuara ka rënë me kalimin e kohës. Si pasojë, është rritur kohëzgjatja mesatare e gjykimeve në këtë gjykatë, si dhe vëllimi i çështjeve të prapambetura. Pranë Gjykatës Administrative të Apelit vihet re se, volumi i çështjeve të vjetra të prapambetura është rritur nga një shifër e menaxhueshme prej 6000 çështjesh në më shumë se 23.000 çështje në vitin 2023. Të dhënat tregojnë se, një nga sfidat më të madha të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është lëshimi më i shpejtë i urdhrave të ekzekutimit, të cilët janë relativisht të thjeshtë nëse i krahasojmë me çështje të themelit. Kjo do të çonte në një ulje drastike të numrit të çështjeve të prapambetura dhe do të lejonte gjykatën të përqendrojë burimet në gjykimin e çështjeve të një natyre më komplekse brenda një afati të shpejtë duke rritur efikasitetin e saj. Gjithashtu, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë ka sfida që duhen kapërcyer lidhur me efikasitetin duke pasur parasysh se me uljen, përgjatë kohës, të numrit të çështjeve administrative të themelit të gjykuara, kohëzgjatja e përgjithshme e gjykimeve po rritet. Veçanërisht çështjet e themelit janë problematike, pasi kohëzgjatja mesatare e tyre është rritur nga 100 në 300 ditë.

Burimet njerëzore

Gjyqtarët

Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve në detyrë (veting), i cili ende vazhdon, ka sjellë krijimin e vakancave të përkohshme dhe të përhershme në sistemin gjyqësor. Mungesa e numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve krijon sfida të mëdha për të zgjidhur të gjitha çështjet brenda një kohe të arsyeshme. Rrjedhimisht, gjyqtarët në detyrë përballen me një ngarkesë të madhe çështjesh.

Në figurën 6 janë përmbledhur rezultatet e procesit të vetingut për periudhën 2018 – 2023.




Figura 6 Rezultatet e rivlerësimit nga KPK-ja përgjatë kohës.

Ajo që tregon grafiku është se, veçanërisht në periudhën 2018 (duke filluar nga tremujori 3) deri në vitin 2022 (tremujori 1) shumë gjyqtarë u shkarkuan ose vendosën të japin dorëheqjen. Grafiku tregon gjithashtu se, veçanërisht në tremujorin e dytë të 2021 dhe në tremujorin e katërt të 2022, një pjesë e madhe e gjyqtarëve u konfirmuan në detyrë. Pavarësisht luhatjeve të normës së konfirmimit përgjatë kohës, në tremujorët e fundit të vitit 2023, kjo normë u rrit në 68%.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është treguar reaktiv duke inkurajuar gjykatat të punësojmë më tepër staf mbështetës në rastet kur janë shënuar ulje të numrit të gjyqtarëve. Në vitin 2020 në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm ushtronin detyrën 41 gjyqtarë dhe 141 staf mbështetës jo gjyqtar. Në vitin 2021 numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë është ulur me 20% ndërsa numri i stafit mbështetës është rritur me 10%. Ndërsa në vitin 2022 vërehet një rritje e vogël me vetëm 5% të numrit të gjyqtarëve dhe 2% të stafit jo gjyqtar. Në vitin 2023 vihet re një ulje me 34% e numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë, por një rritje me 5% e numrit të stafit mbështetës jo gjyqtarë.

Gjykata Administrative e Apelit në 3 vitet e fundit ka vuajtur largimin e gjyqtarëve nga sistemi gjyqësor, shkaktuar nga procesi i vetingut dhe nga numri i lartë i dorëheqjeve. Në vitin 2020 në këtë gjykatë ushtronin efektivisht detyrën 10.5 gjyqtar, ndërsa në vitin 2021 numri i tyre është ulur me 34%. Largimi i gjyqtarëve nga kjo gjykatë ka vijuar edhe në vitin 2022 duke shënuar një rënie me 19%, gjatë vitit 2022 kanë ushtruar efektivisht detyrën 5.58 gjyqtarë. Sikurse vërehet në 2 vite, numri i gjyqtarëve efektiv në këtë gjykatë është përgjysmuar. Për të ulur impaktin e këtij fenomeni në gjykatë janë është shtuar numri i stafit jo gjyqtar me 4% në vitin 2021 dhe me 15% në vitin 2022. Në vitin 2023 numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë është 8.3 gjyqtar duke shënuar një rritje me 49% por përsëri larg numrit të plotë të trupës prej 13 gjyqtarë. Gjithashtu numri i stafit jo gjyqtar është rritur me 46% gjatë vitit 2023 duke arritur në 67 staf mbështetës jo gjyqtar.

Ndryshe nga grupet e tjera të gjykatave, gjykatat administrative janë prekur nga ulja e numrit të burimeve njerëzore në të dyja kategoritë. Në vitin 2020 ushtronin efektivisht detyrën 34.2 gjyqtar të cilët asistoheshin nga 102.2 staf administrativ jo gjyqtar. Në vitin 2021 vërehet një ulje e numrit të gjyqtarëve efektiv me 8%. Ulja e dytë shënohet në vitin 2022 me 17% gjyqtarë më pak krahasuar me vitin 2021. I njëjti trend vërehet në stafin mbështetës të gjyqtarëve. Në vitin 2021 numri i nëpunësve efektivisht në detyrë është ulur me 6% krahasuar me vitin 2020 ndërsa në vitin 2022 numri nëpunësve ka ruajtur pothuaj të njëjtat vlera. Në vitin 2023 numri i gjyqtarëve që ushtron efektivisht detyrën është 23.5 gjyqtarë (17.6 në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë) ose 10% më i ulët se në vitin 2022. Numri i stafit mbështetës 92.9 ose 4% më i ulët se në vitin 2022.

Gjatë vitit 2020, në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ushtronin detyrën efektivisht 190.7 gjyqtarë dhe 528.2 staf jo gjyqtar. Në vitin 2021 është konstatuar një ulje prej 14% e numrit të gjyqtarëve. Ndërsa në vitin 2022 numri total i gjyqtarëve efektivisht në detyrë është ulur me 19%. Të dhënat e vitit 2023 tregojnë se, numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë është 131.9 dhe numri i stafit jo gjyqtar 588. 6, pak a shumë në të njëjtat nivele me vitin 2022.

Aktualisht ka një numër të madh vendesh vakante pranë të katërt gjykatave por kryesisht pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar për të bërë të mundur ngritjen në detyrë brenda afateve ligjore të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë në gjykatën e apelit, çka do të përmirësojë performancën e gjykatës dhe të zvogëlojë volumin e çështjeve (të vjetra) të prapambetura. Për të mundur një numër adekuat të ngritjeve në detyrë në gjykatën e apelit, është urgjente gjithashtu që të sigurohet më shumë hapësirë fizike për këtë gjykatë, pasi ndërtesa e saj aktuale nuk gëzon kushtet infrastrukturore për një rritje të konsiderueshme të numrit të gjyqtarëve. E njëjta problematikë infrastrukturore haset edhe për Gjykatën Administrative të Apelit. Lidhur me plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e shkallës së parë, priten në vitin 2024 të diplomohen 32 gjyqtarë të rinj, në vitin 2025, 45 gjyqtarë të rinj dhe në 2026, 20 gjyqtarë.




Figura 7 Përqindja e gjyqtarëve aktivë në raport me organikën.

Ajo që tregon figura 7 është se, veçanërisht Gjykata e Administrative e Apelit ka një përqindje relativisht të lartë të gjyqtarëve efektivisht në detyrë, krahasuar me gjykatat e tjera për organikën e parashikuar prej 13 gjyqtarësh.² Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë është afër raportit 62%, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë një përqindje relativisht të ulët të gjyqtarëve në detyrë, krahasuar me numrin e vendeve vakante.

Stafi mbështetës

Një nga zgjidhjet për të reduktuar numrin e çështjeve në pritje dhe çështjeve të prapambetura në

² Por kjo është vetëm për shkak të komandimeve të fundit në skemë delegimi dhe nëpërmjet procesit të ngritjes në detyrë –për shkak të ngarkesës së madhe në këtë gjykatë në këtë strategji propozohet rritja e numrit të gjyqtarëve në organikën e kësaj gjykate (shih më poshtë).

gjykata është dhe rritja e kapaciteteve të personelit ndihmës gjyqësor. Aktualisht, krahas mungesës strukturore të gjyqtarëve, gjykatat kanë mungesa të theksuara të kapaciteteve në numra të ndihmësve ligjorë/sekretarëve gjyqësorë në gjykata. Ndërsa në vendet e tjera europiane, gjyqtarët ndihmohen nga personel mbështetës i kualifikuar, kjo është e vërtetë vetëm për një numër të kufizuar gjyqtarësh në Shqipëri. Procedura strikte e përzgjedhjes së ndihmësve/ këshilltarëve ligjorë, e kombinuar me një trajnim paraprak dhe të detyrueshëm në Shkollën e Magjistraturës, si dhe interesi i ulët nga ana profesionistëve të së drejtës për të ndjekur këtë karrierë, rezulton në mungesën strukturore të ndihmësve/këshilltarëve ligjorë. Megjithatë, nëpërmjet kësaj strategjie, Këshilli propozon një alternativë që mund ta zgjidhë këtë problem dhe të çojë në rritjen e numrit të personelit mbështetës në gjykata.

Strategjia për uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura

Misioni dhe vizioni për uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura

Misioni i strategjisë

Gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Shqipëri janë të përkushtuara të japin drejtësi në një mënyrë të shpejtë dhe efikase, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe parimet europiane, duke i dhënë përparësi promovimit të standardeve të larta të efektivitetit dhe cilësisë së gjykimit.

Vizioni i strategjisë

Gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Shqipëri të arrijnë ekselencën duke u karakterizuar nga një ulje e numri të çështjeve të prapambetura në një nivel normal e të pranueshëm, nga vonesa minimale në proceset gjyqësore si dhe nga dhënia e shpejtë e me cilësi e drejtësisë, si e vetmja rrugë për garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve shqiptarë.

Synimet strategjike për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura

Në periudhën 2024 – 2027, për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë dhe gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm dhe administrativ përcaktohen këto synime strategjike:

1. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të gjitha çështjet në pritje mund të zgjidhen në 2025/2026.
2. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, volumi i çështjeve të prapambetura do të ulet me 20 – 30% (pakësim me 10.000 deri në 15.000 çështje).
3. Në Gjykatën Administrative të Apelit, volumi i çështjeve të prapambetura do të ulet me 25% (pakësim i prapambetjes me 5000 çështje).

Strategjia kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura është në përputhje me planin

strategjik të KLGJ-së dhe detajon synimet e mëposhtme të Planit Strategjik të KLGJ-së:

Synimi 1: Përshpejtimi i zbatimit të reformës së pushtetit gjyqësor dhe akordimit të burimeve.

Synimi 2: Zbatimi dhe monitorimi i standardeve për ekselencë gjyqësore.

Synimi 3: Ofrimi efikas i shërbimeve dhe funksionimi më i mirë i gjykatave.

Synimi 4: Fuqizimi i kapaciteteve të brendshme të KLGJ-së.

Synimi 5: Zbatimi dhe përmirësimi i strategjive për komunikimin e jashtëm.

Për të realizuar synimet dhe objektivat e strategjikë të KLGJ-së për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, janë përcaktuar objektivat strategjikë të mëposhtëm:

Objektivi 1: Ulja strukturore e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë, në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 2024 – 2027 nëpërmjet marrjes së masave konkrete.

Objektivi 2:

Fuqizimi i kapaciteteve në gjykata me marrjen e masave për emërimin dhe përshpejtimin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, heqjen e pengesave për përzgjedhjen, trajnimin dhe emërimin e ndihmësve ligjorë në gjykata dhe rritjen në përgjithësi të numrit të stafit mbështetës jo gjyqtar.

Objektivi 3: Përmirësimi i metodave dhe proceseve të punës.

Objektivi 4:

Prezantimi i një pakete ndryshimesh ligjore që synojnë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe zbatimi i masave konkrete për uljen dhe parandalimin e krijimit të çështjeve të prapambetura në gjykata në të ardhmen.

Objektivi 5:

Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasiore dhe matja e performancës së gjyqtarëve.

Objektivi 6:

Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me aktorë të tjerë brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë.

Objektivi 7:

Rritja e Transparencës dhe forcimi i besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Objektivi 1: Ulja strukturore e numrit të çështjeve të prapambetura nëpërmjet marrjes së masave

konkrete për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura

1.1 Krijimi i një inventari të çështjeve të prapambetura në gjykata

Për të identifikuar përmasat e problematikës së volumit të çështjeve të prapambetura, llojet e veçanta të çështjeve që përbëjnë këtë stok si dhe natyrën e çështjeve që kontribuojnë më së shumti në shtimin e tij, ekziston nevoja për inventarizimin e çështjeve të prapambetura në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ Tiranë si dhe në gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm dhe administrativ. Ky proces do të ndihmojë për të kuptuar se cilat lloje e natyrash çështjesh kanë numrin më të lartë dhe cilat janë më të vjetrat për të zbatuar më pas masat konkrete për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura bazuar në parimet e gjykimit me përparësi të çështjeve të caktuara të natyrës urgjente, nivelit të ulët të kompleksitetit dhe renditjes kronologjike të tyre.

1.2 Krijimi i ekipeve për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura

Praktikat më të mira ndërkombëtare dhe ato vendase kanë treguar se ngritja e ekipeve për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura mund të ndihmojë në identifikimin e llojeve/natyrës së çështjeve të prapambetura, kohën e pritjes dhe hartimin e masave për gjykimin e tyre. Shpesh, ekipet për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura përbëhen nga një grup gjyqtarësh, të mbështetur nga ndihmës ligjorë/ sekretarë gjyqësorë apo nëpunës të tjerë të posaçëm për uljen e çështjeve të prapambetura. Ndihmësit ligjorë/ sekretarët gjyqësorë apo nëpunësit e tjerë të posaçëm mund të kryejnë një tërësi hapash paraprake përgatitore të tilla si shqyrtimi paraprak i historikut të çështjes, përmbledhja e rrethanave të faktit dhe parashtrimi i bazës ligjore.

1.3 Përfshirja e masave të menaxhimit aktiv të çështjeve si menaxhimi i diferencuar i çështjeve, filtrimi dhe grupimi i çështjeve

Në menaxhimin e diferencuar të çështjeve, çështjet e ardhura klasifikohen në bazë të llojit, natyrës, urgjencës dhe kompleksitetit. Çështjet urgjente, ato të thjeshta apo kategori të tjera çështjesh të vendosura nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, do të klasifikohen dhe grupohen për trajtimin e tyre me prioritet me qëllim evadimin e një numri më të madh çështjesh në një kohë më të shkurtër. Kjo qasje do t'i lejojë më shumë mundësi gjykatave që t'i kushtojnë burimet dhe kohën e duhur trajtimit të çështjeve më komplekse duke rritur në të njëjtën kohë edhe cilësinë e vendimmarrjes. Në përputhje me këtë qasje, grupimi i çështjeve është një tjetër masë efektive për të përmirësuar efikasitetin e drejtësisë. Për shembull, çështjet e prapambetura, do të mund të grupohen së bashku dhe të shqyrtohen nga gjykata në të njëjtën kohë dhe në mënyrë unanime nga trupa gjyqësore, gjë që do të shkurtojë kohën e nevojshme për shqyrtimin e tyre dhe do të mundësojë marrjen e vendimeve (standarde). Kjo masë parashikohet të zbatohet pasi është zbatuar në mënyrë efektive *inventarizimi* i çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit.³ Në mënyrë që vendimmarrjet të mund të konsolidohen dhe çështjet e prapambetura të mund të zgjidhen në një mënyrë më të shpejtë. Menaxhimi i diferencuar i çështjeve kërkon gjithashtu që gjyqtarët të punojnë për parandalimin e krijimit të çështjeve të prapambetura në të ardhmen, duke rezervuar një përqindje të caktuar të kohës së tyre për shqyrtimin e çështjeve të reja të ardhura sipas grupçështjeve prioritare. Kjo do të ndihmonte për të parandaluar që çështjet e reja të ardhura me natyrë prioritare të bëhen në të ardhmen çështje të prapambetura.

1.4 Miratimi i planeve individuale të veprimit nga ana e gjykatave

Menjëherë pas miratimit të kësaj strategjie, gjykatat në përputhje me objektivat strategjike të trajtuara në këtë strategji do të hartojnë planin individual të veprimit me masa dhe afate konkrete për zbatimin e tyre. Gjithashtu, gjykatat mund të përcaktojnë indikatorë matës edhe më ambiciozë për rritjen e produktivitetit dhe uljen e çështjeve të prapambetura. Një model plani veprimi jepet në shtojcën nr. 1. **Objektiivi 2: Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit (gjyqtarëve dhe ndihmësve ligjorë)**

2.1 *Plotësimi i vakancave nëpërmjet emërimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor nga krijimi e në vijim, ka vlerësuar me përparësi nevojat e sistemit gjyqësor për gjyqtarë të rinj. Krahas përcaktimit të kuotave për kandidatë gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë që pranohen e trajnohen nga Shkolla e Magjistraturës, KLGJ-ja ka vlerësuar si nevojë imediate edhe përfundimin në mënyrë të shpejtë dhe efikase të procedurave të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë dhe të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në gjykatat e apelit. Numri i vendeve vakante në gjykata mbetet i lartë, për shkak të procedurave komplekse të procesit të rivlerësimit apo të vlerësimit të ankesave nga ILD-ja sipas ligjit në fuqi, ndaj është identifikuar e nevojshme rritja dhe forcimi i bashkëpunimit të KLGJ-së me institucionet e tjera si Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Kolegji i Posaçëm i Apelit, me rolin e të cilave ndërlihet ky proces, në mënyrë që gjykatat të plotësojnë sa më shpejt trupën gjyqësore të nevojshme për të përballuar ngarkesën dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. KLGJ-ja mbetet e angazhuar në përfundimin e këtyre proceseve jetike për të përballuar ngarkesën e gjykatave, uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe dhënien e drejtësisë në mënyrë

³ Si praktikë e mirë, mund t'i referohemi Gjykatës së Lartë, ku si pjesë e një projekti të financuar nga USAID/INL, është zhvilluar një inventar i çështjeve të mbetura në këtë gjykatë.

të shpejtë. KLGJ-ja në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet e efikasitetit të pushtetit gjyqësor është e detyruar të shpërndajë gjyqtarët në një mënyrë të tillë që ngarkesa mes gjyqtarëve të jetë e barabartë, për aq sa është e mundur, si dhe që raporti mes numrit të gjyqtarëve aktualë kundrejt numrit të pozicioneve që nevojiten, të jetë i njëjtë për çdo gjykatë.

Nisur nga analiza e faktorëve që ndikojnë në numrin e gjyqtarëve, të tillë si: ndikimi i parashikuar i procesit të vetingut dhe përfundimi i tij, rritja e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve (duke rritur numrin e gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit), diplomimi i gjyqtarëve të rinj gjatë 2024-2026, komandimet në institucionet e tjera dhe daljet në pension, është e mundur që të vlerësohet një zhvillim i mundshëm i numrit të gjyqtarëve duke parashikuar se numri i plotë i gjyqtarëve do të plotësohet në vitin 2028, referuar qasjes së ekuilibruar:

- Numri i gjyqtarëve në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të arrijë numrin e 70 gjyqtarëve në vitin 2026 dhe numrin e plotë të trupës gjyqësore në vitet 2027-2028.
- Numri i gjyqtarëve në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, të arrijë numrin e 27 gjyqtarëve (trupa e plotë gjyqësore) në vitin 2027.
- Numri i gjyqtarëve në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, të arrijë numrin e 16 gjyqtarëve në vitin 2026 dhe 19 gjyqtarë (trupa e plotë gjyqësore) në vitet 2027-2028.
- Numri i gjyqtarëve në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të arrijë numrin e 60 gjyqtarëve në vitin 2026 dhe 78 gjyqtarë (trupa e plotë gjyqësore) në vitet 2027-2028.

2.2 Rritja e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit

Pas një analize të kombinuar të të gjithë indikatorëve, faktorëve dhe objektivave të parashikuar nga neni 14 i ligjit nr. 98/2016 i ndryshuar, me qëllim ekuilibrimin e ngarkesës së gjykatave në Shqipëri, Gjykata Administrative e Apelit do të ketë nevojë për të paktën 19 pozicione gjyqtarësh (krahasuar me 13 pozicione që ka aktualisht), si mekanizmi kryesor i ekuilibrit të ngarkesës së gjykatës dhe vetë gjyqtarëve, duke siguruar një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në juridiksionin e apelit. Për të përcaktuar ngarkesën e punës, treguesit janë vlerësuar duke kërkuar vendosjen e një ekuilibri midis shpërndarjes së ngarkesës së punës, shpërndarjes së gjyqtarëve, si dhe numrit minimal të gjyqtarëve në çdo gjykatë. Ngarkesa e gjykatës është përcaktuar jo vetëm nga numri total i çështjeve të reja, por edhe nga lloji i këtyre çështjeve, pra nëse çështjet e ndërlikuara dhe ato që marrin kohë përbëjnë përqindjen më të vogël apo atë më të madhe të çështjeve të një gjykate.

2.3 Rritja e numrit dhe thjeshtimi i procesit të punësimit të ndihmësve ligjorë/stafit tjetër mbështetës jo gjyqtar

Për të rritur efikasitetin e dhënies së drejtësisë në gjykata, duhet të rritet jo vetëm numri i gjyqtarëve, por edhe i ndihmësve ligjorë apo stafit tjetër mbështetës jo gjyqtar. Për të përforcuar delegimin e punës administrative nga gjyqtarët te stafi mbështetës, referuar edhe standardeve ndërkombëtare nevojiten të ketë staf të mjaftueshëm (ndihmës ligjorë dhe sekretarë gjyqësorë/ staf tjetër mbështetës jo gjyqtar) në dispozicion për të ndihmuar gjyqtarët. Ndryshimet ligjore të propozuara synojnë rritjen e numrit të ndihmësve ligjorë deri në dy ndihmës ligjorë për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, rritjen e trajtimit të tyre financiar si një mjet nxitës për përzgjedhjen e kësaj karriere nga ana e profesionistëve të së drejtës dhe lehtësimin e procedurave të rekrutimit të tyre duke parashikuar të njëjtën procedurë me rekrutimin e nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë në gjykata.

2.4 Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimit të ndihmësve ligjorë/stafit tjetër mbështetës jo gjyqtar

Gjithashtu në vëmendje të KLGJ-së qëndron edhe nevoja e trajnimit të vazhdueshëm të ndihmësve ligjorë dhe stafit tjetër mbështetës jo gjyqtar në drejtim të rritjes së kapaciteteve të tyre në mbështetjen e gjyqtarëve dhe kryerjen me cilësi të detyrave të deleguara nga ta. Thellimi i njohurive në çështje të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, apo çështjeve të administrimit gjyqësor do të adresohet nga KLGJ-ja nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të njësive së trajnimit në KLGJ, ashtu edhe rritjes së bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës për arritjen e këtij objekti.

Objektivi 3: Përmirësimi i metodave të punës

3.1 Delegimi i detyrave të caktuara në lidhje me çështje të thjeshta nga gjyqtari te stafi i gjykatës (ndihmës ligjorë dhe/ose sekretarë gjyqësorë me përvojë)

Delegimi i detyrave të caktuara në fazën paraprake të një gjykimi ose në përfundim të tij nga gjyqtari te stafi mbështetës i gjykatës përbën tashmë një praktikë të pilotuar në gjyqësorin shqiptar. Kjo masë ka rezultuar efektive në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Duke qenë se ngarkesa e madhe e gjykatave të shkallës së parë po shkaktohet nga një volum i madh i kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit, kjo masë mund të ndihmojë në shkurtimin e kohëzgjatjes së përgatitjes dhe hartimit të urdhrat të ekzekutimit. Një qasje e ngjashme, mund të ndiqet edhe në fusha të tjera të së drejtës civile dhe administrative në rastin e kërkesave pa palë kundërshtare apo çështjeve të tjera me karakter jo kompleks. Një kusht i rëndësishëm për një delegim të suksesshëm, megjithatë, ka të bëjë me gatishmërinë e gjyqtarëve për të deleguar (duke mbajtur përgjegjësinë e tyre për çështjen) dhe një kualifikim të duhur (përvojë pune, njohuri dhe aftësi) të ndihmësve ligjorë/sekretarëve të gjykatës apo staf tjetër mbështetës jo gjyqtar. Në çdo rast të tilla masa duhet të jenë të unifikuara për të sjellë rezultatin e dëshiruar.

3.2 Nxitja e shkëmbimit të versioneve elektronike të dokumenteve gjyqësore si vendimeve gjyqësore ndërmjet gjykatave apo aktorëve të tjerë në proces

Në pritje të një digjitalizimi të plotë të dosjeve të çështjeve dhe aplikimit të sistemeve moderne të informacionit për menaxhimin e çështjeve, gjykatat e apelit (dhe gjykatat e tjera), duhet të kenë mundësinë të marrin kopjen elektronike të vendimeve gjyqësore dhe dokumenteve të tjera të dosjeve të çështjeve në format elektronik. Në vend të një praktike ku personeli i gjykatës duhet të rishkruajë elementet e një vendimi gjyqësor në një relacion që do të përgatitet për gjyqtarët (në rast të mungesës së një versioni elektronik të një vendimi gjyqësor) apo elementet e ankimeve a kërkesave me karakter të ndryshëm, stafi mbështetës i një gjykate, mund të përdorë drejtpërdrejt një version digjital të tyre nëpërmjet shkëmbimit të formatit elektronik midis gjykatave apo edhe nëpërmjet të forcimit të bashkëpunimit me aktorë të tjerë në proces si përfaqësuesit ligjor, prokurorët, ekspertët etj. Për çështjet e vjetra, përdorimi nga gjykata të skanerëve sikurse po ndodh aktualisht për vendimet gjyqësore, mund të ndihmojë në krijimin e skedarëve digjitalë dhe të redaktueshëm, të cilët do të kursejnë kohë të vlefshme në përgatitjen e çështjeve sidomos në gjykatat e apelit. Zbatimi i një mase të tillë kërkon mbështetje më të madhe financiare.

3.3 Zhvillimi i seancave gjyqësore në distancë

Një masë tjetër efektive që do të ndihmojë në parandalimin e rritjes së numrit të çështjeve të prapambetura, përfshin promovimin e zhvillimit të seancave gjyqësore në distancë. Një metodë e përdorur nga gjykatat shqiptare gjatë periudhës së pandemisë, në kushte të jashtëzakonshme, por që aktualisht vijon të përdoret në praktikën e gjykatave të huaja edhe si një metodë pune në kushte normale. Meqenëse kohëzgjatja e seancave gjyqësore është një nga faktorët kryesorë që ndikon në ngarkesën e gjyqtarëve, një rritje/ulje e mundshme e çështjeve të prapambetura, mund të ndikohet nga zbatimi i një mase të tillë. Kjo masë mund të jetë veçanërisht e aplikueshme për çështjet e standardizuara dhe të thjeshta.

3.4 Përdorimi i modeleve standarde për vendimet gjyqësore/ urdhrat e gjykatës e dokumente të tjera

Modelet standarde mund të kontribuojnë pozitivisht në reduktimin e kohës së nevojshme që gjyqtarët, ndihmësit ligjorë dhe sekretarët gjyqësorë apo stafi tjetër mbështetës jo gjyqtar, shpenzojnë për hartimin dhe konceptualizimin e vendimeve dhe urdhrave të gjykatës. Projektet pilot të mëparshme të zbatuara në gjykatat shqiptare kanë treguar se, për shembull, në fushën e urdhrave të ekzekutimit, përdorimi i shablloneve mund të ndihmojë në kufizimin e kohës së punës të shpenzuar gjatë fazës paraprake dhe në hartimin e vendimeve/urdhrave. Gjithashtu është e nevojshme hartimi i modeleve standarde për hartimin e relacionit nga ana e ndihmësve ligjorë apo akteve të tjera të nevojshme gjatë gjykimit që mund të përdoren nga sekretarët gjyqësorë apo stafi tjetër mbështetës jo gjyqtar. Për një

zbatim efektiv të modeleve, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të bashkëpunojë ngushtësisht me këshillat e gjykatave për të ngritur grupe të posaçme punë për hartimin e tyre. Në mënyrë më ideale, këto modele do të integrohen në sistemet e informacionit të menaxhimit të çështjeve dhe të dokumenteve në të ardhmen.

3.5 Zgjedhje më efektive e trupave gjykues të gjykatave të apelit

Për shkak të procesit të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit, mundësitë e përjashtimit të gjyqtarëve nga disa trupa gjykues janë rritur, pasi këta gjyqtarë mund të kenë marrë vendime në të kaluarën si gjyqtarë të shkallës së parë për të njëjtën çështje. Kur ndodh kjo situatë, gjyqtari i përjashtuar duhet të zëvendësohet dhe, për rrjedhojë, të krijohet një *trup gjykues i përzier*. Riorganizimi i trupave gjykues kërkon kohë dhe, gjyqtari i ri i trupit gjykues, duhet ta shqyrtojë çështjen nga fillimi. Për të reduktuar vonesat e shkaktuara nga krijimi i trupave gjykues të përzier, është e nevojshme që sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të ketë mundësi të identifikojë gjyqtarin e shkallës së parë në mënyrë të tillë që çështja të caktohet rastësisht një trupe tjetër gjyqësore.

Objektivi 4: Ndryshimet ligjore të përqendruara në uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura

4.1 Promovimi i një gjyqtari të vetëm në gjykata

Promovimi i modelit të gjykimit të çështjes nga një gjyqtar i vetëm në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, për lloje të veçanta çështjesh, veçanërisht për çështjet relativisht të thjeshta dhe të standardizuara, është parashikuar të aplikohet me anë të ndryshimeve ligjore të propozuara. Ndryshimet dhe shtesat në Kodin e Procedurës Civile si dhe në ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” vijnë si rezultat i evidentimit të nevojave për të përmirësuar shpejtësinë e gjykimit të disa kategorive të caktuara dhe të kufizuara të çështjeve civile, njëkohësisht duke lehtësuar procedurat për gjykimin e tyre, si edhe ngarkesën e punës së trupave gjykuese dhe të gjyqtarëve të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Qëllimi i ndryshimeve të propozuara është rritja e efikasitetit dhe efektshmërisë në sistemin e drejtësisë në tërësi dhe atë gjyqësor në veçanti, nëpërmjet rregullimeve procedurale për rritjen e kategorive të çështjeve civile që mund të shqyrtohen dhe vendosen në gjykatën e apelit me një gjyqtar, pra jo me trupë kolegjiale të përbërë prej 3 gjyqtarësh, duke mundësuar për këto kategori të kufizuar çështjesh zhvillimin e proceseve gjyqësore më efikase dhe në kohë më të shkurtër. Gjithashtu në të njëjtën linjë janë paraqitur edhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale për shqyrtimin me një gjyqtar të vetëm të kategorive të caktuara të çështjeve.

Sipas të dhënave statistikore, në tërësinë e tyre, kategoritë e çështjeve që propozohen të gjykohen në gjykatat e apelit me një gjyqtar, do të përbënin rreth 15% të çështjeve që, nëpërmjet ankimeve apo ankimeve të veçanta, i paraqiten për shqyrtim gjykatave të apelit.

4.2 Kufizimi i mundësisë së ankimit për një lloj çështjeje të caktuar në fushën e së drejtës civile dhe administrative

Ndryshimet e propozuara synojnë edhe kufizimin e mundësisë së ankimit për disa çështje administrative dhe civile. Kjo, jo vetëm që do të çojë në uljen e ngarkesës së punës së gjykatës, por edhe në mundësi më të mira për gjykatat e apelit për t’u fokusuar në çështje komplekse. Vlen të theksohet se në rast kufizimi të së drejtës së ankimit për kategori të caktuara çështjesh të propozuara, të tilla si paditë me vlerë të ulët, të gjitha garancitë ligjore për aksesin në drejtësi, do të mbeten të paprekura sipas legjisllacionit kombëtar dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

4.3 Ndryshime ligjore në sistemin për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit

Sipas të dhënave statistikore të Gjykatës së Shkallë Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, urdhrat e ekzekutimit që janë lëshuar për titujt ekzekutivë nga kjo gjykatë përbëjnë gjithsej 41,2 % të numrit të çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtarët e kësaj gjykate. Në vitin 2023, urdhrat e ardhur për shqyrtim (së bashku me urdhrat e mbartura për shkak mosshqyrtimi nga viti pararendës) përbëjnë 33 % të çështjeve gjyqësore të prapambetura. Në vitet 2021-2022 urdhrat e ekzekutimit përbëjnë mesatarisht 50 % të çështjeve gjyqësore në këtë gjykatë. Ndërkohë që urdhrat e ekzekutimit që lëshohen nga Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë përbëjnë pothuajse 30 % të ngarkesës së gjyqtarëve. Kjo situatë e jashtëzakonshme, kërkon ndërhyrje edhe të natyrës legjisllative me qëllim që të ulët numri i çështjeve të tilla të prapambetura dhe të parandalohet shtimi i tyre në të ardhmen. Për këtë qëllim janë hartuar propozime konkrete për ndryshim e Kodit të Procedurës Civile.

Heqja e asaj pjese të urdhrave të ekzekutimit, të cilat referuar përmbajtjes së tyre dhe zhvillimeve të fundit të legjislationit të BE-së dhe standardeve të CEPEJ nuk kanë nevojë për shqyrtim gjyqësor paraprak për lëshimin e tyre, do të ulte ngarkesën e punës së gjyqtarëve dhe do të rrisë efikasitetin. Në të njëjtën kohë, do të krijohen hapësira për përqendrimin e kohës dhe aftësive të gjyqtarëve në evadimin e çështjeve gjyqësore të tjera, duke ndikuar në pasjen e më shumë kohe në dispozicion për studimin dhe arsyetimin më të mirë të vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e themelit me një natyrë më komplekse.

Objekti 5: Përcaktimi i standardeve minimale të kohës dhe sasisë dhe matja e performancës

5.1 Përcaktimi i standardeve minimale të kohës dhe sasisë për gjyqtarët

Për një strategji efektive për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura në të ardhmen, është thelbësore që gjykatat të kenë standarde minimale të kohës dhe sasisë të përditësuar, të bazuara në performancën mesatare ndër vite të gjykatave shqiptare dhe në procedurë. KLGJ-ja, në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me gjyqtarët do të përcaktojë standarde minimale të kohës dhe sasisë të gjykimit të çështjeve me qëllim rritjen e efikasitetit të gjykatave duke u bazuar në parimet e mirëqeverisjes, efektivitetit, transparencës dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. KLGJ-ja synon të arrijë vendosjen e standardeve të njëjta për të gjithë gjyqtarët, ngarkesë të ekuilibruar të punës në gjykata dhe rritjen e besimit të publikut në gjyqësor.

5.2 Matja e performancës së ndihmësve ligjorë

Ekziston nevoja për të vënë në zbatim një sistem të objektivave të performancës të gjyqtarëve të kombinuuar me një sistem të matjes së performancës për ndihmësit ligjorë (dhe sekretarët e gjykatave). Nëse gjyqtarët duhet të rrisin produktivitetin e tyre ata duhet të mbështeten nga një staf mbështetës produktiv. Për këtë arsye, nëpërmjet kësaj strategjie propozohet vendosja e objektivave të performancës për ndihmësit ligjorë (dhe/ose sekretarët gjyqësorë) dhe zhvillimin e një sistemi të unifikuar të matjes së performancës për stafin e gjykatave. Për një zbatim efektiv KLGJ-ja do të bashkëpunojë ngushtësisht me këshillat e gjykatave për të ngritur grupe të posaçme punë për hartimin e këtyre standardeve.

5.3 Përmirësimi i metodave të mbajtjes së statistikave gjyqësore sipas llojeve të veçanta të çështjeve

Që një sistem i matjes së performancës së gjykatave të jetë efikas duhet që gjykatat të mbajnë statistika të detajuara sipas llojit e natyrës së çështjes. Këto statistika do të përdoren për të monitoruar zhvillimin e çështjeve të prapambetura në gjykata, ngarkesën e gjyqtarëve etj. Të gjitha gjykatat, bazuar në treguesit kryesorë të performancës së tyre, me aplikimin e standardeve europiane për matjen e performancës së gjykatave (si udhëzimet e CEPEJ e SATURN të KiE), do të vijnë në inkurajohen që të përdorin statistikat e performancës për të monitoruar performancën e gjyqtarëve individualë, trupave gjyqësore, sektorëve në gjykata dhe stafit të tyre mbështetës. Arritja e këtij objekti do të kërkojë zhvillime të qëndrueshme dhe unifikim të sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve.

Objekti 6: Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me aktorë të tjerë

6.1 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me bashkëpunëtorët e gjykatave

Për uljen e çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të tyre në të ardhmen është e një rëndësie të veçantë forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet KLGJ, gjykatave, e institucioneve apo aktorëve të tjerë të jashtëm. Koordinimi me institucionet e tjera të pavarura, ministritë e linjës apo agjencitë qeveritare mund të ndihmojë në zhvillimin e proceseve gjyqësore më të shpejta. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, është gjithashtu thelbësor në mënyrë të tillë që nisma të suksesshme në uljen e çështjeve të prapambetura si ajo e zbatuar në Gjykatën e Lartë të zbatohen edhe në gjykata të tjera veçanërisht në ato të apelit.

6.2 Zhvillimi i takimeve periodike

Siç u theksua edhe më lart, koordinimi me institucionet e tjera të pavarura, ministritë e linjës apo agjencitë qeveritare mund të ndihmojë në zhvillimin e proceseve gjyqësore më të shpejta dhe efikase duke ndikuar kështu jo vetëm në kohëzgjatjen mesatare të çështjeve gjyqësore por edhe në krijimin e hapësirave në kohën gjyqësore për shqyrtimin e çështjeve më komplekse e si rrjedhojë edhe uljes së numrit të çështjeve të prapambetura. Gjykatat inkurajohen të zhvillojnë takime periodike me bashkëpunëtorët e sistemit të drejtësisë për të diskutuar problematikat e përbashkëta dhe rritur urat e bashkëpunimit.

Objektivi 7: Rritja e Transparencës dhe e Besimit të Publikut

7.1 Informimi i publikut mbi masat e ndërmarra

Numri i konsiderueshëm i çështjeve të prapambetura, shoqëruar me një periudhë të gjatë funksionaliteti jo normal të disa gjykatave, ka çuar në një rënie të madhe të besimit të publikut në gjyqësor mbi cilësinë e drejtësisë. KLGJ-ja dhe gjykatat pranojnë nevojën për të vepruar në një mënyrë të tillë që drejtësia jo vetëm të jepet, por edhe të duket që jepet. Masat e ndërmarra dhe ato që do të planifikohen të zbatohen në të ardhmen duhet t'i përcillen publikut në mënyrë të kuptueshme me qëllim rritjen e besimit të gjykatat. KLGJ-ja, në zbatim të Synimit nr.5 të Planit Strategjik dhe të Strategjisë së Komunikimit të Sistemit Gjyqësor, do të marrë masat e duhura për një komunikim të vazhdueshëm, transparent, të mirinformuar, profesional dhe të besueshëm me publikun dhe me palët e tjera të interesit.

7.2 Publikimi i rezultateve në uljen e çështjeve të prapambetura

KLJGJ-ja dhe gjykatat do të publikojnë në një rubrikë të caktuar të krijuar në faqet përkatëse të internetit, në mënyrë të periodike rezultatet e arritura falë zbatimit të kësaj strategjie. Kjo qasje do të mundësojë mbledhjen dhe analizimin e të dhënave statistikore në kohën e duhur, duke qenë kështu burimi primar për përcaktimin e masave prioritare në gjykata.

Llogaridhënia, Monitorimi dhe Vlerësimi

Për të matur ecurinë e zbatimit të strategjisë së uljes të çështjeve të prapambetura dhe nivelin e arritjes së qëllimeve dhe objektivave strategjike, masat e propozuara të zbatuara në nivel individual do të monitorohen nga gjykatat dhe KLGJ-ja në baza të rregullta mujore.

Për monitorimin dhe planifikimin e synuar, do të përdoret tabela në shtojcën nr. 2 me masat dhe veprimet.

Skenarët për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura

Për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ në Tiranë dhe gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm dhe administrativ, janë zhvilluar skenarë të ndryshëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, bazuar në supozimet se në vitet në vijim gjykatat do të kenë rritje graduale deri në plotësimin e numrit të gjyqtarëve në detyrë, rritje të performancës gjyqësore, përmirësim të metodave të punës në drejtim të efikasitetit dhe ndryshimet ligjore do të jenë miratuar e vënë në zbatim në kohë. Siç u nënvizua më lart, ritmi i uljes së numrit të çështjeve të prapambetura mund të ndikohet pozitivisht dhe në mënyrë të konsiderueshme vetëm nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në gjykata (gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë), e kombinuar me zbatimin e masave për uljen e volumit dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura, si dhe miratimin e shpejtë të ndryshimeve ligjore që synojnë të menaxhojnë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata. Skenarët marrin në konsideratë ecurinë e numrit të çështjeve të prapambetura në çështjet "kryesore" (duke mos përfshirë kërkesat dhe urdhrat e ekzekutimit⁴).

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në kohën e hartimit të këtij skenari, kishte 12.218 çështje themeli në pritje të gjykimit dhe koha mesatare e pritjes ishte 1.6 vite. Performanca e një gjyqtari në këtë gjykatë ishte mesatarisht 249 çështje themeli të gjykuara për gjyqtar në vit. Skenari i paraqitur grafikisht më poshtë bazohet në supozimet se në periudhën 2024 – 2028 numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë do të rritet në një total prej 80 gjyqtarësh, numri i çështjeve të ardhura do të ketë ecuri të ngjashme me vitin 2023 dhe gjyqtarët do të mund të rrisin produktivitetin e tyre sipas standardeve minimale të sasisë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve mbështetëse në gjykata (ndihmës ligjorë dhe sekretarë gjyqësorë), e kombinuar me zbatimin e masave për uljen e volumit dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura, si dhe miratimin e shpejtë të ndryshimeve ligjore që synojnë të menaxhojnë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata.

⁴ Megjithatë, për Gjykatën e Rrethit Tiranë, e cila gjithashtu ka një problem specifik me numrin e madh të urdhrave të ekzekutimit, një analizë plotësuese ka treguar se me rritjen e pritshme të numrit të gjyqtarëve, vonesat në urdhrat e ekzekutimit eliminohen vetëm në pak vite.

Skenari i mëposhtëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura është i arritshëm vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative e graduale supozimet e mësipërme.




Figura 9 Skenari i uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Nëse ecuria e numrit të çështjeve të ardhura dhe performanca e gjyqtarëve individualë mbeten të njëjta, atëherë pritet që gjykata të jetë në gjendje të ulë numrin e të gjitha çështjeve të prapambetura në vitin 2027. Në rast se zbatohen masat e tjera shtesë për uljen e numrit dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura, si dhe miratohet në kohë paketa e ndryshimeve ligjore të për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, pritet që edhe më herët të ndodhë një pakësim i ndjeshëm i çështjeve të prapambetura në këtë gjykatë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në kohën e hartimit të skenarit të mëposhtëm, kishte 11.721 çështje në pritje të gjykimit. Koha e pritjes së këtyre çështjeve ishte 2.5 vjet.

Ashtu si Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka një numër të madh vendesh vakante. Sipas analizave të të dhënave në lidhje me ngarkesën dhe performancën e kësaj gjykate, numri i gjyqtarëve duhet të rritet në 27 gjyqtarë (në vitin 2027-2028). Performanca e gjyqtarëve aktualë është 398 çështje në vit. Me supozimin se numri i çështjeve të ardhura mbetet i njëjtë në të ardhmen, produktiviteti i gjyqtarëve mbetet i njëjtë/rritet, ndërsa numri i gjyqtarëve rritet në 27, mund të arrihet skenari i mëposhtëm i uljes së numrit të çështjeve të prapambetura.




Figura 10 Skenari i uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën Administrative të Shkallës

Nga figura 10 rezulton se, të gjitha çështjet e prapambetura mund të arrijnë në zero në vitin 2028. Nëse zbatohen masat shtesë, si dhe miratohen ndryshimet ligjore, mund të arrihet një ritëm edhe më i shpejtë i uljes së numrit të çështjeve të prapambetura.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm vërehet një numër shumë i lartë i çështjeve në pritje të gjykimit, i cili në kohën e hartimit të këtij skenari arrinte në 52.818 çështje në pritje të gjykimit. Aktualisht janë 26 gjyqtarë në detyrë dhe sipas organikës së miratuar pas riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave (harta e re gjyqësore) duhet të jenë 78 gjyqtarë. Produktiviteti i një gjyqtari aktualisht është 347 çështje të gjykuara në vit.

Në figurën 11 janë paraqitur skenarë të ndryshëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, bazuar në rritje të ndryshme të produktivitetit të gjyqtarëve, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve mbështetëse në gjykata (ndihmës ligjorë dhe sekretarë gjyqësorë), e kombinuar me zbatimin e masave për uljen e volumit dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura, si dhe miratimin e shpejtë të ndryshimeve ligjore që synojnë të menaxhojnë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata. Kështu në rastin kur produktiviteti do të rritet me 10%, atëherë numri i çështjeve në vit për gjyqtar do të jetë 382 çështje, nëse produktiviteti do të rritet me 20%, atëherë numri i çështjeve në vit për gjyqtar do të jetë 417 çështje dhe nëse produktiviteti do të rritet me 50%, atëherë numri i çështjeve në vit për gjyqtar do të jetë 521 çështje. Këta skenarë bazohen në supozimin se, do të ketë një rritje strukturore të gjyqtarëve me kalimin e kohës, niveli i çështjeve të ardhura do të mbetet i pandryshuar në të ardhmen e afërt dhe masat e parashikuara në këtë strategji janë zbatuar. Nëse produktiviteti i gjyqtarëve rritet me 10% deri në 20%, kjo do të thotë që në vitin 2029 çështjet e prapambetura mund të bien në 15.000 çështje. Vetëm duke rritur produktivitetin me 50% të gjitha çështjet e prapambetura do të pastrohen deri në vitin 2029. Ndaj zbatimi i njëkohshëm i masave shtesë për uljen e numrit dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura, si dhe miratimi në kohë i ndryshimeve ligjore për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, është veçanërisht thelbësor në përmbushjen sa më shpejt të objektivave në mënyrë që të ndodhë edhe më herët një pakësim i ndjeshëm i çështjeve të prapambetura në këtë gjykatë.




Figura 11 Skenarët e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjykata Administrative e Apelit

Ashtu si Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, edhe Gjykata e Apelit Administrativ përballet me një volum të madh çështjesh në pritje të gjykimit. Në kohën e hartimit të skenarit të mëposhtëm, në gjykatë ishin 23.104 çështje të prapambetura. Produktiviteti i gjyqtarëve ishte 225 çështje të gjykuara për gjyqtar në vit. Në figurën 12 janë dhënë skenarë të ndryshëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, nëse nuk është e mundur të rritet produktiviteti ose nëse gjyqtarët do të arrijnë të gjykojnë më shumë çështje në një vit të caktuar.

Kështu nëse produktiviteti do të rritet me 20%, atëherë numri i çështje në vit për gjyqtar do të jetë 270 çështje, nëse produktiviteti do të rritet me 50% atëherë numri i çështje në vit për gjyqtar do të jetë 338 çështje dhe nëse produktiviteti do të rritet me 80% atëherë numri i çështje në vit për gjyqtar do të jetë 405 çështje për gjyqtar.

Skenari tregon se nëse produktiviteti mbetet i pandryshuar, në fund të vitit 2030 do të jenë ende 20.000 çështje të prapambetura në Gjykatën Administrative të Apelit. Me një rritje të produktivitetit prej 20%, volumi reduktohet në 15.000 çështje. Vetëm me një rritje drastike të produktivitetit volumi i çështjeve të prapambetura mund të zvogëlohet ndjeshëm (në rast të rritjes së produktivitetit prej 50%, në vitin 2030 do të ketë afërsisht 7000 çështje të prapambetura dhe me një rritje të produktivitetit prej 80% çështjet e prapambetura do të zhduken në vitin 2030). Ndaj zbatimi i njëhershëm i masave shtesë për uljen e numrit dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura, si dhe miratimi në kohë i ndryshimeve ligjore për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, është veçanërisht thelbësor në përmbushjen sa më shpejt të objektivave në mënyrë që të ndodhë edhe më herët një pakësim i ndjeshëm i çështjeve të prapambetura në këtë gjykatë.




Figura 12 Skenarët për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën Administrative të Apelit.

Përfundime të përgjithshme të skenarëve (përfshirë objektivat për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura)

Nga analiza e mësipërme konstatohet se, problematikat më të mëdha shfaqen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në atë Administrative të Apelit. Për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ Tiranë, situata është më e mirë, sepse me rritjen strukturore të numrit të gjyqtarëve, me rritjen e produktivitetit të gjyqtarëve dhe me të njëjtin nivel çështjesh të ardhura, çështjet e prapambetura mund të evadohen edhe më herët se viti 2027. Për dy gjykatat e apelit situata është e ndryshme. Nëse gjykatat e apelit nuk e rrisin produktivitetin e tyre (numri i çështjeve që gjykohen për gjyqtar në vit) në vitin 2030 do të ketë ende një numër të lartë të çështjeve të prapambetura. Pavarësisht nga rritja strukturore e numrit të gjyqtarëve nga viti 2024 – 2030, do të jetë nevoja për të zbatuar masa shtesë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, kombinuar me ndryshime imediate infrastrukturore dhe ndryshimet ligjore, rritjen e produktivitetit të gjyqtarëve si dhe rritjen e stafit mbështetës jo gjyqtar për menaxhimin e çështjeve të prapambetura në mënyrë më efektive dhe për të arritur objektivin e uljes realiste të numrit të çështjeve të prapambetura.

Konkluzionet dhe rekomandimet për zbatimin e strategjisë

Qëllimi i strategjisë është të përcaktojë masat dhe afatet kohore për gjykatat në lidhje me uljen në një nivel normal dhe të pranueshëm të çështjeve të prapambetura.

Për një zbatim të suksesshëm të strategjisë kombëtare për uljen e çështjeve të prapambetura duhet të merren parasysh tre faktorë kritikë. Faktori i parë kritik është lidhësia. Udhëheqja efektive është thelbësore për fillimin e ndryshimeve, përmirësimin e performancës në gjykata, për zhvillimin e një vizioni të ardhshëm për gjyqësorin dhe për të inkurajuar gjyqtarët dhe stafin për të ecur përpara. Mbetet prioritar forcimi i kapaciteteve menaxhuese të këshillave të gjykatave, përmes mbështetjes së tyre me trajnime për zhvillimin e aftësive drejtuese dhe vizionare në zbatimin e një strategjie moderne të menaxhimit të burimeve njerëzore që përqendrohet në përmirësimin e performancës së gjyqtarëve dhe stafit, të kombinuara me përdorimin e zgjidhjeve novatore për të arritur një performancë më të mirë të gjykatave.

Faktori i dytë kritik është mbështetja institucionale vendase dhe ajo e partnerëve ndërkombëtarë. Gjatë zbatimit të strategjisë për uljen e çështjeve të prapambetura, KLGJ-ja me qëllim miradministrimin e pushtetit gjyqësor, do të japë mbështetjen maksimale për gjykatat individuale me një sërë vendimmarrjesh me qëllim rritjen e efikasitetit. Duke qenë se zbatimi i disa masave sjell ndikim në buxhetin e shtetit dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme për miratimin e paketës së ndryshimeve ligjore, KLGJ-ja ka nevojë për mbështetjen institucionale me prioritet të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave. Pa këtë mbështetje, ky dokument do të mbetet fiktiv dhe pa vlerë. Në zbatim të prioritetëve dhe parashikimeve në përmbushjen e vakancave, Këshilli ka nevojë për mbështetjen institucionale të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, institucioneve të rivlerësimit kalimtar apo institucioneve të tjera roli i të cilave është vendimtar në procesin e promovimit të gjyqtarëve. Bashkëbisedimi me aktorë të tjerë në proces dhe profesionistët e së drejtës ka gjithashtu një rol kyç. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, është gjithashtu thelbësor në mënyrë të tillë që nisma të suksesshme në uljen e çështjeve të prapambetura si ajo e zbatuar në Gjykatën e Lartë të zbatohen edhe në gjykata të tjera veçanërisht në ato të apelit.

Faktori i fundit dhe i tretë kritik për një zbatim të suksesshëm të strategjisë kombëtare për uljen e çështjeve të prapambetura, ka të bëjë me nevojën për të investuar në përmirësimin e matjes së performancës së gjykatave dhe statistikave të fokusuara në çështjet e prapambetura sipas treguesve të CEPEJ. Studimi i ngarkesës së gjyqtarëve sipas llojit të veçantë të çështjeve apo aplikimi i metodave të peshimit të çështjeve në matjen e performancës gjyqësore do të sillte përmirësimin të dukshme në alokimin e burimeve të nevojshme gjyqësore dhe mbështetëse.

Është e domosdoshme që procesi i uljes së çështjeve të prapambetura të monitorohet vazhdimisht në mënyrë periodike nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja nëpërmjet hartimit të raporteve për ecurinë e uljes së çështjeve të prapambetura, bazuar në modelin e miratuar. Këto raporte do të ofrojnë një pasqyrë të mirë në ecurinë e uljes së çështjeve të prapambetura në gjykata, nëse gjykatat janë në gjendje të arrijnë objektivat strategjike të përcaktuara nga KLGJ-ja. Është gjithashtu e rëndësishme që Këshilli të mund të reagojë në kohë të shpejtë në raste kur këto objektiva rrezikojnë të mos realizohen.

Shtojcat

Shtojca 1: Plani i Veprimit - Reduktimi i çështjeve të prapambetura në Gjykatë

Plani i veprimit – Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatë Parathënie:

Strategjia Kombëtare për Uljen e Çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, përcakton gjerësisht të gjitha veprimet që nevojiten për të rivendosur gjykatat në funksionalitet të plotë dhe për të adresuar numrin gjithnjë në rritje të çështjeve të prapambetura. Ky plan veprimi përcakton synimet, objektivat, aktivitetet kryesore, afatet kohore dhe treguesit e suksesit që nevojiten për të përmirësuar metodat dhe proceset e punës në gjykata. Për të adresuar problematikën e çështjeve të prapambetura është i domosdoshëm planifikimi i mëtejshëm dhe përcaktimi i hapave që do të ndërmerren në kuadër të veprimtarive, për të siguruar kështu përmbushjen e synimeve dhe objektiveve të përcaktuara. Prandaj, ky dokument shërben për t'i shtjelluar më tej këto veprimtari të mëtejshme dhe hapat që lidhen me zbatimin e tyre.

Përkufizimi i çështjeve të prapambetura:

Për qëllimet e këtij dokumenti dhe të planifikimit të veprimeve brenda gjykatës, çështjet e prapambetura janë përcaktuar gjerësisht si çdo çështje (më e vjetër se 24 muaj për çështjet civile, më e vjetër se 12 muaj për çështjet administrative dhe ato të natyrës penale) dhe do të trajtohen njësoj si çështjet e depozituara në gjykatë gjatë ose para vitit 2022 (për çështjet civile) dhe 2023 (për çështjet administrative dhe penale). Tabela në vijim tregon numrin aktual të çështjeve të prapambetura në gjykatë, të ndara sipas kategorive:

Viti	Çështjet Civile	Çështjet Penale
2010		
2011		
2012		
2013		
2014		
2015		
2016		
2017		
2018		
2019		
2020		
2021		
Nëntotali i synuar i çështjeve të prapambetura		
2022		
2023		
Totali i ngarkesës me çështje në vazhdim		

Synimet dhe objektivat:

Synimet dhe objektivat e këtij plani veprimesh janë të lidhura drejtpërsëdrejti me synimet dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare për Uljen e Çështjeve të Prapambetura të KLGJ-së.

Hapat e veprimit:

Për të adresuar çështjet e prapambetura, gjykata do të ndërmarrë veprimtaritë e përcaktuara në këtë plan veprimi, për të siguruar përmbushjen e synimeve dhe objektivave.

Matja e performancës:

Veprimtaritë individuale dhe afatet e planifikuara për përmbushjen e tyre përcaktohen në këtë plan.

Ndërsa, monitorimi dhe vlerësimi i plotë do të ndiqet çdo muaj nëpërmjet raportimit pranë KLGJ-së për përmbushjen e objektivave nëpërmjet skemës:

→ **Të përmbushura** - të shoqëruara edhe me shënime që tregojnë nëse janë përmbushur sipas planit, ose nëse e kanë tejkaluar planin; → **Në zhvillim e sipër / ende në zbatim**; → **Nuk kanë filluar ende të zbatohen**.

Veprimet konkrete:

Veprimtaria 1 – Inventarizimi i çështjeve të prapambetura

Përkufizimi: Gjykata do të inventarizojë dhe kategorizojë të gjitha çështjet që janë përkufizuar si çështje të prapambetura, sipas përkufizimit të mësipërm.

Synimi: Përfundimi i inventarit në datën 30 qershor 2024 (shembull), ose para saj.

Palët përgjegjëse: Sektori i Arkivit dhe Regjistrimit dhe staf tjetër i gjykatës me detyra të përcaktuara për të përmbushur këtë qëllim

Hapat drejt përmbushjes:

Realizimi kundrejt synimit: Planifikuar të nisë/ Në proces/Drejt Përfundimit (80%+)/ Përfunduar

Shpjegim: Për shembull: Një total prej 52.818 çështjesh civile dhe penale të arkivuara në ambientet e Gjykatës apo pranë Zyrave të Shërbimit janë inventarizuar dhe kategorizuar.

Reziqet:

Për shembull: Gjykata nuk ka një numër të mjaftueshëm të stafit të saj për të angazhuar në këtë proces, që do të lejonte në të njëjtën kohë përmbushjen e plotë të detyrave të tyre të zakonshme në gjykatë.

Veprimtaria 2 – Kategorizimi i çështjeve të prapambetura

Përkufizimi: Gjykata (Mbledhja e përgjithshme e Gjyqtarëve dhe Këshilli i Gjykatës) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor bien dakord dhe ndërtojnë një skemë grupimi për çështjet, për të identifikuar, kategorizuar dhe shqyrtuar çështjet që janë të një natyre urgjente dhe jo komplekse.

Synimi: Çështjet e prapambetura janë grupuar brenda disa nënkategorive më të detajuara. Gjithashtu, një listë e çështjeve me prioritet është krijuar për ato çështje që janë të një natyre urgjente, jo komplekse dhe që mund të adresohen menjëherë nga gjykata. Lista me çështjet prioritare miratohet nga Këshilli i Gjykatës/Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve në Korrik 2024 (shembull).

Palët përgjegjëse: Gjyqtarët, ndihmësit ligjorë, KLGJ-ja/ Komisionet e Përhershme/ Ad Hoc, projektet mbështetëse.

Hapat drejt përmbushjes:

- Raporti i çështjeve civile/ penale/administrative të inventarizuara;
- Skema e kategorizimit të çështjeve/grupimit të çështjeve;
- Listat e përfunduara të çështjeve prioritare;
- Miratimi i listës me çështje prioritare nga Këshilli i Gjykatës/Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve.

Realizimi kundrejt synimit: Planifikuar të nisë/ Në proces/Drejt Përfundimit (80%+)/ Përfunduar

Shpjegim: Për shembull: Gjykata ka përfunduar inventarizimin dhe klasifikimin e çështjeve gjyqësore

Raporti për inventarizimin – korrik 2024.

Skema e kategorizimit të çështjeve/kritereve të përcaktuara – Korrik 2024.

Listat e përfunduara të çështjeve – Korrik 2024.

Miratimi i listës me çështje prioritare nga Këshilli i Gjykatës/Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve – Korrik 2024

Rreziqet:

Për shembull: Gjykata nuk ka një numër të mjaftueshëm të stafit të saj për të angazhuar në këtë proces, që do t'i lejonte në të njëjtën kohë përmbushjen e plotë të detyrave të tyre të zakonshme në gjykatë.

Veprimtaria 3 – Miratimi i objektivave konkretë për uljen e backlogut

Përkufizimi: Mbështetur në skemën e prioritetit të plotësuar në Hapin 2, mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve miraton objektivat konkretë për uljen e backlogut sipas listave prioritare dhe gjykimit sipas vitit të regjistrimit të çështjeve. KLGJ-ja vë në dispozicion të gjykatës objektivat e propozuara nga ekspertët ndërkombëtarë. Gjykata diskuton dhe miraton objektivat e matshëm.

Synimi: Miratimi i objektivave Shtator 2024

Palët përgjegjëse: Gjyqtarët, ndihmësit ligjorë, KLGJ-ja/ Komisionet e Përhershme/ Ad Hoc, projektet mbështetëse..

Hapat drejt përmbushjes:

Realizimi kundrejt synimit: Planifikuar të nisë/ Në proces/Drejt Përfundimit (80%+)/ Përfunduar

Shpjegim **Rreziqet:**

Veprimtaria 4 – Ngritja e Komisionit Adhoc për uljen e backlogut në gjykatë

Përkufizimi: Gjykata ngre një Komision Ad Hoc për uljen e backlogut i përbërë nga gjyqtarë të të dyja dhomave/seksioneve, ndihmës ligjorë, Kancelari dhe sekretarë gjyqësorë. Komisioni harton listat prioritare paraprake për shqyrtim nga Mbledhja e Përgjithshme, është përgjegjës për hartimin paraprak të dokumenteve standardë dhe propozimeve konkrete për përmirësimin e metodave të punës, të parashikuara në veprimtaritë e mëposhtme.

Synimi: Afati

Palët përgjegjëse: KLGJ, Kryetari i Gjykatës, gjyqtarët, ndihmësit ligjorë, Kancelari, sekretarët gjyqësorë të caktuar në grupin e punës, projektet mbështetëse.

Realizimi kundrejt synimit: Planifikuar të nisë/ Në proces/Drejt Përfundimit (80%+)/ Përfunduar

Shpjegim

Rreziqet:

Veprimtaria 5 – Përgatitja e dokumenteve standarde si vendime, formularë relacioni etj

Përkufizimi: Komisioni Ad Hoc për uljen e backlogut me mbështetjen e KLGJ dhe projekteve mbështetëse harton vendime standarde për kategori të caktuara çështjesh aty ku është e mundur, relacionin standard për ndihmësit ligjorë dhe akte të tjera standarde të nevojshëm për një gjykim të shpejtë efikas dhe cilësor.

Synimi: brenda vitit 2024 Palët

përgjegjëse:

Hapat drejt përmbushjes:

Realizimi kundrejt synimit: Planifikuar të nisë/ Në proces/Drejt Përfundimit (80%+)/ Përfunduar

Shpjegim **Rreziqet:**

Veprimtaria 6 – Monitorimi i performancës së gjyqtarëve/ ndihmësve ligjorë përkundrejt objektivave të realizuara

Përkufizimi: Mbështetur në skemën e prioritetit dhe objektivave të caktuara nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, Kryetari i Gjykatës, Kancelari dhe Komisioni Ad Hoc hartojnë raporte të performancës mujore, tre mujore dhe vjetore përkundrejt përmbushjes së objektivave. **Synimi: në vazhdimësi**

Palët përgjegjëse:

Realizimi kundrejt synimit: Planifikuar të nisë/ Në proces/Drejt Përfundimit (80%+)/

Përfunduar

Shpjegim

Rreziqet:

Veprimtaria 7 – Përmirësimi i metodave të punës

Përkufizimi: Komisioni Ad Hoc për uljen e backlogut me mbështetjen e KLGJ dhe projekteve mbështetëse, mbështetur në strategjinë për uljen e backlogut dhe ekspertizën ndërkombëtare, propozon përmirësimin e metodave të punës së njësisë ligjore, sekretarisë gjyqësore etj. për një gjykim të shpejtë efikas dhe cilësor.

Synimi: brenda 2024 Palët

përgjegjëse:

Hapat drejt përmbushjes:

Realizimi kundrejt synimit: Planifikuar të nisë/ Në proces/Drejt Përfundimit (80%+)/ Përfunduar

Shpjegim **Rreziqet:**

Veprimtaria 8 – Bashkëpunimi me gjykatat e shkallës së parë, Gjykatën e Lartë dhe aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë

Përkufizimi: Gjykata realizon takime me gjykatat e shkallës së parë, Gjykatën e Lartë dhe aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë me qëllim forcimin e bashkëpunimit, diskutimin e problematikave të përbashkëta dhe krijimin e marrëveshjeve që do të ndihmonin për një gjykim të shpejtë efikas dhe cilësor.

Synimi: në vazhdimësi

Palët përgjegjëse:

Realizimi kundrejt synimit: Planifikuar të nisë/ Në proces/Drejt Përfundimit (80%+)/

Përfunduar

Shpjegim

Rreziqet:

Shtojca 2: Plani strategjik me masat, planifikimet e propozuara, veprimet që duhen ndërmarrë dhe lista e treguesve për matjen e arritjes së qëllimeve, strategjitë për reduktimin e çështjeve të prapambetura të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit në Shqipëri.

Masat për reduktimin dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	Objektivi strategjik i KLGJ	Aktivitetet kryesore	Data e fillimit	Kush e drejton	Statusi	Treguesit e suksesit
Objektivi 1: Ulja strukturore e çështjeve të prapambetura nëpërmjet marrjes së masave konkrete për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura						
1.1 Krijimi i një inventari të çështjeve të prapambetura në gjykata	1	<input type="checkbox"/> Miratimi i udhëzimit të KLGJ për inventarizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura	Maj 2024	KLGJ	Përfunduar	Miratimi i udhëzimit
		<input type="checkbox"/> Krijimi i ekipeve të inventarizimit dhe trajnimit të tyre	Maj 2024	KLGJ; Gjykatat; Projektet mbështetëse		Nr. i nëpunësve përgjegjës të trajnuar për inventarizimin

38

Masat për reduktimin dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	Objektivi strategjik i KLGJ	Aktivitetet kryesore	Data e fillimit	Kush e drejton	Statusi	Treguesit e suksesit
---	-----------------------------	----------------------	-----------------	----------------	---------	----------------------

		<input type="checkbox"/> Inventarizimi i çështjeve të prapambetura	Qershor 2024	KLGJ; Gjykatat; Projektet mbështetëse		38 000 çështje të inventarizuara në Gjykatën e Apeli të Përgjithshëm 23 000 çështje të inventarizuara në Gjykatën Administrative të Apelit 20 000 çështje të inventarizuara në Gjykatën e Shk1 të Përgjithshëm Tiranë 8000 çështje të inventarizuara në Gjykatën e Shk1 Administrative Tiranë
1.2 Krijimi i ekipeve për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura	1		Maj 2024	Gjykatat		
1.3 Përfshirja e masave të menaxhimit aktiv të çështjeve (si menaxhimi i diferencuar i çështjeve, filtrimi dhe grupimi i çështjeve)	3	<input type="checkbox"/> Hartimi i ndryshimeve të vendimit nr. 78 të KLGJ mbi shqyrtimin e çështjeve me përparësi	Maj 2024	KLGJ	Në proces	Miratimi i projektvendimit
		<input type="checkbox"/> Hartimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë	Maj 2024	Kuvendi	Në proces	Miratimi i projektligjit
		<input type="checkbox"/> Hartimi i listave të grupçështjeve	2024	KLGJ/ Gjykatat		Miratimi i listave

Masat për reduktimin dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	Objektivi strategjik i KLGJ	Aktivitetet kryesore	Data e fillimit	Kush drejton	Statusi	Treguesit e suksesit
1.4 Miratimi i planeve individuale të veprimit nga ana e gjykatave	1	<input type="checkbox"/> Hartimi i Planeve individuale te veprimit	Maj 2024	Gjykatat		Miratimi i planeve nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatave përkatëse
Objektivi 2: Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit (gjyqtarëve dhe ndihmësve ligjorë)						
2.1 Plotësimi i vakancave nëpërmjet emërimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.	2	<input type="checkbox"/> Promovimi i gjyqtarëve	2024-2027	KLJGJ		Promovimi i 12 gjyqtarëve në vit
		<input type="checkbox"/> Hartimi i udhërrëfyesit për plotësimin e vakancave	Maj 2024	KLJGJ		
		<input type="checkbox"/> Ndjekja e procesit hap pas hapi dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional	2024-2027	KLJGJ		
2.2 Rritja e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit	2	<input type="checkbox"/> Hartimi i projektvendimit të KLGJ mbi rritjen e nr. të gjyqtarëve	Maj 2024	KLJGJ	Në proces	Miratimi i projektvendimit
		<input type="checkbox"/> Konsultimi sipas kërkesave të ligjit	Maj 2024	KLJGJ		
		<input type="checkbox"/> Miratimi i rritjes së numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve	2024	Kuvendi		Miratimi i rritjes së numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve

2.3 Rritja e numrit dhe thjeshtimi i procesit të punësimit të ndihmësve ligjorë/stafit tjetër mbështetës jo gjyqtar	2	<input type="checkbox"/> Hartimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor	Maj 2024	KLJGJ		Miratimi i ndryshimeve ligjore
---	---	---	----------	-------	--	--------------------------------

Masat për reduktimin dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	Objektivi strategjik i KLJGJ	Aktivitetet kryesore	Data e fillimit	Kush e drejton	Statusi	Treguesit e suksesit
		<input type="checkbox"/> Miratimi i ndryshimeve ligjore nga Kuvendi	2024	Kuvendi		
		<input type="checkbox"/> Përcaktimi i organikave dhe numrit të ndihmësve ligjorë në njësite ligjore të gjykatave përkatëse	2024-2027	KLJGJ/MF/Kuvendi		Caktimi i dy ndihmësve ligjorë për gjyqtar në organikë Rekrutimi i plotë i tyre
		<input type="checkbox"/> Rritja graduale e numrit të stafit mbështetës jo gjyqtar	2024-2027	KLJGJ/MF/Kuvendi		Caktimi i dy sekretarëve gjyqësorë për gjyqtar në organikë Rekrutimi i plotë i tyre
2.4 Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimit të ndihmësve ligjorë/stafit tjetër mbështetës jo gjyqtar	2	<input type="checkbox"/> Hartimi i kurrikulës së trajnimit vazhdues	Maj-Qershor 2024	KLJGJ/SHM / Projektet mbështetëse		Miratimi i kurrikulës
		<input type="checkbox"/> Zhvillimi i trajnimit	Qershor 2024	KLJGJ/SHM / Projektet mbështetëse /Gjykatat		Nr. i ndihmësve të trajnuar
		<input type="checkbox"/> Përsëritja e trajnimit me rekrutimin e ndihmësve të rinj	2024-2027	KLJGJ/SHM /gjykatat		Nr. i ndihmësve të trajnuar

Objektivi 3: Përmirësimi i metodave të punës						
3.1 Delegimi i detyrave të caktuara në lidhje me çështje të thjeshta nga një gjyqtar te stafi i gjykatës (ndihmës ligjorë dhe/ose sekretarë gjyqësorë me përvojë)	3		2024-2027	Gjykatat		

Masat për reduktimin dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	Objektivi strategjik i KLGJ	Aktivitetet kryesore	Data e fillimit	Kush e drejton	Statusi	Treguesit e suksesit
3.2 Nxitja e shkëmbimit të versioneve elektronike të dokumenteve gjyqësore si vendimeve gjyqësore ndërmjet gjykatave apo aktorëve të tjerë në proces	3		2024-2027	Gjykatat dhe KLGJ		
3.3 Zhvillimi i seancave gjyqësore në distancë	3		2024-2027	Gjykatat		
3.4 Përdorimi i modeleve standarde për vendimet gjyqësore/ urdhrat e gjykatës e dokumente të tjera	3		2024-2027	Gjykatat dhe KLGJ		
3.5 Zgjedhje më efektive e trupave gjykues të gjykatave të apelit	3		2024-2027	Gjykatat dhe KLGJ		
Objektivi 4: Ndryshimet ligjore të përqendruara në uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura						
4.1 Promovimi i një gjyqtari të vetëm në gjykata	3 dhe 4	Hartimi i projektligjit për ndryshimin e kodeve të procedurës	Maj 2024	KLJGJ		
		Miratimi i projektligjeve	2024	Kuvendi		Miratimi i projektligjit
4.2 Kufizimi i mundësisë së ankimit për një lloj çështjeje të caktuar në fushën e së drejtës civile dhe administrative	3 dhe 4	Hartimi i projektligjit për ndryshimin e kodeve të procedurës	Maj 2024	KLJGJ		
		Miratimi i projektligjeve	2024	Kuvendi		Miratimi i projektligjit

4.3 Ndryshime ligjore në sistemin për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit	3 dhe 4	Hartimi i projektligjit për ndryshimin e kodeve të procedurës	Maj 2024	KLGG		
		Miratimi i projektligjit	2024	Kuvendi		Miratimi i projektligjit
Objektivi 5: Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasiore dhe matja e performancës						
5.1 Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasiore për gjyqtarët	3	<input type="checkbox"/> Hartimi i projektvendimit të KLGJ	Maj 2024	KLGG	Në proces	Miratimi i projektvendimit

Masat për reduktimin dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	Objektivi strategjik i KLGJ	Aktivitetet kryesore	Data e fillimit	Kush e drejton	Statusi	Treguesit e suksesit
		<input type="checkbox"/> Konsultimi me gjykatat	Maj 2024	KLGG/ Gjykatat		Nr. i mendimeve të përcjella
		<input type="checkbox"/> Mbledhja e raporteve periodike dhe konsultimi i ecurisë me gjykatat	2024-2027	KLGG/ Gjykatat		Nr. i raporteve të përgatitura Nr. i konsultimeve të ecurisë të zhvilluara
5.2 Matja e performancës së ndihmësve ligjorë	2	<input type="checkbox"/> Hartimi i projektvendimit model për performancën e ndihmësve ligjorë	Maj 2024	KLGG/ Gjykatat		Miratimi i vendimit
5.3 Përmirësimi i metodave të mbajtjes së statistikave gjyqësore sipas llojeve të veçanta të çështjeve	2		2024-2027	KLGG/ Gjykatat		
Objektivi 6: Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me aktorë të tjerë						

6.1 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me bashkëpunëtorët e gjykatave	5	Hartimi i modeleve standarde të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucionale	Maj-Qershor 2024	Gjykatat dhe KLGJ		Miratimi i modeleve
		Lidhja e marrëveshjeve me institucionet e rëndësishme të veçantë për zbatimin e masave	2024-2027	Gjykatat dhe KLGJ		Nr. i marrëveshjeve të lidhura
6.2 Zhvillimi i takimeve periodike	5	Thirrja e bashkëpunëtorëve të gjykatave/ aktorëve kryesorë në mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve	2024-2027	Gjykatat dhe KLGJ		Nr. i mbledhjeve të zhvilluara
		Zhvillimi i takimeve periodike sipas nevojës për zbatimin e masave	2024-2027	Gjykatat dhe KLGJ		Nr. i takimeve të zhvilluara

Masat për reduktimin dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura	Objektivi strategjik i KLGJ	Aktivitetet kryesore	Data e fillimit	Kush e drejton	Statusi	Treguesit e suksesit
Objektivi 7: Rritja e Transparencës dhe e Besimit të Publikut						
7.1 Informimi i publikut mbi masat e ndërmarra	5	Prezantimi i strategjisë në mbledhje të përbashkët pune të gjykatave me përfaqësues të medias etj.	Maj 2024	KLGJ dhe gjykatat		Nr. i pjesëmarrësve në takim Nr. i mediave që ndoqi takimin
		Publikimi i strategjisë në faqet përkatëse dhe media sociale	Maj 2024	KLGJ dhe gjykatat		Publikimi në faqe

7.2 Publikimi i rezultateve ne uljen e çështjeve të prapambetura	5	Hartimi i modeleve standarde të raportimit të ecurisë së zbatimit të strategjisë	Qershor – korrik 2024	KLGJ dhe gjykatat		Miratimi i modeleve
		Publikimi i raporteve tre mujore	2024-2027	KLGJ dhe gjykatat		Nr. i raporteve të publikuara
		Publikimi i analizave vjetore të gjykatave	2024-2027	KLGJ dhe gjykatat		Nr. i analizave të publikuara

